

Akt Thmelimi

I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“Roman”

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe kodin civil ne fuqi te Republikën e Shqiperise ne ligjin nr 9901 te dates 14.04.2008 per tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare, dhe dispozitat e tjera te legjislacionit Shqiptar ne fuqi qe rregullojne maredhenjet e Shoqerive Tregëtare.

Ortaku themelues:

Shan Ndoci I paisur me nr ID G00518075Q krijone Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar “Roman” sh.p.k me akt themelimi si vijon :

Formulim

Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur “Roman” sh.p.k . Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtrje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortakët themelues .

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private “Roman” sh.p.k do te kete seline kryesore **Tirane, Njesia Bashkiake nr.7, rruga Sali Butka, pallati 65, kati 1**. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikës se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem .

Objektivi I Veprimtarise

Neni 3

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- 1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat : “Turizëm Dentar, shërbime marketing, agjensi udhëtimi”**. Sidoqofte, asgje nuk do te interpretohet ketu si kufizim i mundesise se shoqerise per te hyre ne tregje apo aktivitete dhe operacione te tjera tregtare pavaresisht se keto aktivitete te mundshme nuk jane permendur ketu shprehimisht.



Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per nje periudhe 5(pese vjet) e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar, data 09.11.2023 deri 08.11.2028

Afati i permundur ne piken 1 te ketij neni mund zgjatet me vendim te Ortakut te vetem, ne perputhje me rregullat e percaktuara nga ky Statut me perfundimin e periudhes se percaktuar me siper.

Kapitali I Shoqerise

Neni 5

Kapitali fillestar I shoqerise private "Roman" s h.p.k do te jete 100.000(njeqind mije leke).

Kapitali i perket aksionerit te vetem te shoqerise, **Shan Ndoci**

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te paksohet (por jo nen vleren nominale te kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi I Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj **Shan Ndoci**, ortaku i Shoqerise dhe perfaqesuesi ligjor i saj . Ai eshte perfaqesuesi I Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues I pajisur me prokure te posacme .

Neni 7

Kapitali i perket aksionerit te shoqerise, **Shan Ndoci**

Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakut te vetem , e ndare ne 1 kuot .

Kuotat e Kapitalit Themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, pasi te jete marre miratimi i ortakeve te tjere te shoqerise, duke respektuar te drejten e parablerjes, kur transferimi behet me ane te shitjes

Neni 8

Ortaket kane te drejte te emeroje nje administrator, financiere, likujdator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake

- a. Ortaku i vetem Z. Shan Ndoci
- b. Administratori Z. Shan Ndoci

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Tirane



Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Krijimin e Shoqerive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .


Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise “Roman” sh.p.k

Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku I vetem .

ORTAKU THEMELUES
“Roman”shpk

Shan Ndoci

Handwritten signature of Shan Ndoci in blue ink, consisting of the name 'Shan Ndoci' and a stylized monogram below it.